



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1648 datë 13.07.2011

Për

“Miratimin e Kushteve të Përgjithshme të Kontratës së Pajtitimit (Kontratë Tip) së Albanian Mobile Communications sh.a., për shërbimin publik telefonik të qëndrueshëm”.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 13.07.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Miratimi i Kushteve të Përgjithshme të Kontratës së Pajtitimit për Shërbimin publik telefonik të qëndrueshëm të sipërmarrësit AMC sh.a.

BAZA LIGJORE:

1. Pika 5, neni 99 të ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);

2. Ligji nr. 9902, datë 17.04.2008 “ Për mbrojtjen e konsumatorëve” (*Ligji nr. 9902*);
3. Neni 15, e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
4. Pika 17, e nenit 21, të “Rregullores së Brendshme të AKEP” (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24. 04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3, të nenit 138, të ligjit nr. 9918;

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë nga:

- Shkresa me nr. 1401/3 Prot., datë 27.05.2011 (nr. 505/5 Prot. i AKEP, datë 27.05.2011,) “*Kërkesë për miratim të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës së Pajtitimit*” për Shërbimin publik telefonik të qëndrueshëm.
- Shkresën nr. 1401/5 Prot., datë 17.06.2011 (nr. 505/7 Prot., datë 17.06.2011, AKEP) për “*Formularin e pajtitimit në rrjetin e telefonisë fikse AMC*”, për Shërbimin publik telefonik të qëndrueshëm.
- Projektvendimin mbi “Miratimin e Kushteve të Përgjithshme të Kontratës së Pajtitimit (Kontratë Tip) së Albanian Mobile Communications sh.a., për shërbimin publik telefonik të qëndrueshëm”;
- Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (*Relacioni*);

si dhe duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

V Ë R E N:

1. AMC sh.a., me shkresën nr. 1401/3 Prot., datë 27.05.2011, dhe me shkresën nr. 1401/5 Prot., datë 17.06.2011, kërkon miratimin e Kushteve të Përgjithshme të Kontratës dhe të Formularit të Pajtitimit të Telefonisë Fikse, bazuar në Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008, “*Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë*”.

2. AMC, referuar Njoftimit me nr. 500 datë 25.03.2011, dhe Konfirmimit të Njoftimit nr. 500/1(Prot.i AKEP) datë 04.04.2011 (marrë prej AMC me nr. 1401/1 Prot., datë 05.04.2011) për ofrimin e shërbimit publik telefonik të qëndrueshëm, i bashkëngjit “*Kushteve të Përgjithshme të Kontratës së Pajtitimit*”, edhe “*Formularin e Pajtitimit*” për shërbimin publik telefonik fiks në rrjetin e operatorit Albanian Mobile Communications sh.a.

3. Për sa më sipër, duke qenë se,

- AMC sh.a., në hartimin e Kushteve të Përgjithshme të Kontratës së Pajtitimit (Kontratë Tip) në rrjetin e telefonisë fikse, ka marrë në konsideratë dhe siguron mbrojtje të konsumatorit sipas përcaktimeve parashikimeve të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, të ligjit nr. 9902, dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që rregullojnë këtë marrëdhënie, si dhe praktikave më të mira rregullatore në vendet e BE-së dhe të rajonit, dhe,

- Me qëllimin e mbrojtjes sa më të mirë të konsumatorit, bazuar në:

i. Qëllimin e garantimit të shërbimeve të duhura dhe të pershtatshme në Shqipëri, të shprehur në nenin 1, të ligjit nr. 9918, dhe,

ii. Objektivat rregullatore për mbrojtjen e interesave të përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike, të shprehur në gërmat ‘a’ dhe ‘b’, pika 3, neni 7 i ligjit nr. 9918,

AKEP, konstaton se kërkesa e AMC është e drejtë dhe e bazuar,

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të këtij dokumenti për sipërmarrësin dhe për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, si dhe pika 17, neni 21 të Rregullores së Brendshme të AKEP, e ndryshuar,

V E N D O S:

1. Të miratojë “*Kushtet e Përgjithshme të Kontratës së Pajtitimit (Kontratë Tip)*”, dhe “*Formularin e Pajtitimit*” për shërbimin publik telefonik të qëndrueshëm, të depozituara në AKEP nga Albanian Mobile Communications sh.a., me shkresat Nr. 1401/3 Prot., datë 27.05.2011 dhe Nr.1401/5 Prot., datë 17.06.2011.

2. Albanian Mobile Communications sh.a.të publikojë në faqen e saj të Internetit Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (Kontratë Tip), të miratuara me këtë vendim.
3. Të njoftohet AMC sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARËT:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURÇE**